

RRJETI PËR ZHVILLIM RURAL I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË **e-buletini**

nr.03 qershor 2012



PUBLIKON

Rrjeti për zhvillim rural i
Republikës së Maqedonisë
www.ruralnet.mk
email: info@ruralnet.mk

"Orce Nikolov"

188-1/8 1000 Skopje
R. e Maqedonisë
T: +389 (2) 3075 506
F: +389 (2) 3075 503

**Në këtë
edicion:**

Në fokus



**Adaptimi i
bujqësisë ndaj
ndryshimeve
klimatike 2**



.....
"ULJA E CO2 DUKE NDRYSHUAR
PREJ KARBURANT FOSILI ME
BIOMASË – MBETURINA DRURI" 4
.....



.....
„NËPËRMJET DRITARES SË TË
NESËRMES MË TË MIRË” 5
.....



.....
„TË KUJDESEMI PËR KULTURËN DHE
TRADITËN – Zhvillimi i turizmit në
krushevë” 6
.....



.....
DIMENSIONET E
SHUMTA TË LEADER DHE
BASHKËPUNIMI 7
.....



.....
DEKLARATA E BRUKSELIT: Ruajtja e
ardhmërisë së qasjes LEADER 10
.....

.....
PROJEKTI - Biorajone 12
.....



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



МРЕЖА ЗА РУРАЛЕН РАЗВОЈ
НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА



**ADAPTIMI I BUJQËSISË NDAJ
NDRYSHIMEVE KLIMATIKE**



PROJEKTI NË USAID PËR ADAPTIMI I BUJQËSISË NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Rrjeti për zhvillim rural në Republikën e Maqedonisë (RZR i RM-së) ka filluar me zbatimin e projektit “Adaptim i Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike”, prej 12 prill të vitit 2012, përkrahur nga USAID- Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar.

Qëllimi i projektit është të promovon praktikat adaptuese bujqësore dhe të rrit vetëdijen e prodhuesve bujqësor, por edhe të publikut të gjerë mbi sfidat dhe efektet nga ndryshimet klimatike në sektorin bujqësor në Republikën e Maqedonisë.

Zbatimi i projektit do të zhvillohet në zonën e detit Mesdhe duke përfshinë edhe rajonin pranë lumit Vardar, me një pjesë të Strumicës dhe Gjevgjelisë, që paraqet një rajon që në masë më të madhe është ndikuar nga ndryshimet klimatike dhe do të përbëhet prej dy komponentëve kryesore.

Komponenti i parë i projektit është testimi dhe demonstrimi i praktikave inovative bujqësore për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike, me anë të cilave do të minimizohen disa nga ndikimet e jovolitshme që priten të paraqiten si rezultat i nxehjes globale mbi kulturat e vreshtarisë, pemëtarisë dhe kopshtarisë. Grup synues i këtij komponenti janë ekonomitë familjare bujqësore dhe fermerët, që e shesin tepricën e prodhimeve në tregjet lokale.

Komponenti i dytë është drejtuar kah rritja e vetëdijes dhe kapaciteteve të palëve të interesuara për ndryshimet klimatike dhe do të përfshin realizimin e kampanjave informative në nivel lokal dhe kombëtar. Teknologjitë e testuar nga komponenti i parë do të zhvillohen në pako këshillimore, që do të shpërndahen tek grupet synuese nëpërmjet një sërë punëtorive dhe medieve tjera përkatëse. Grupi synues i këtij komponenti është popullata rurale në Republikën e Maqedonisë, si dhe institucionet relevante që kanë mandat të zhvillojnë dhe zbatojnë programe për zhvillim.

Aktivitetet e planifikuara të RZR-së, që do të zbatohen nëpërmjet projektit “Adaptim i Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike” janë hapat e para që ndërmerren në fushën e masave adaptive të zbatuara në fermë, kështu që në masë të madhe do të ndihmon përmirësimin e praktikave të qëndrueshme në sistemet bujqësore në Republikën e Maqedonisë.



“ULJA E CO₂ DUKE NDRYSHUAR PREJ KARBURANT FOSILI ME BIOMASË – MBETURINA DRURI”

Shoqata Kombëtare e Pronarëve të Pyjeve Private – NZ “Privatni Shumi”



Më 01 dhjetor 2011 filloi realizimin i projektit “Ulja e CO₂ duke ndryshuar prej karburant fosili me biomasë – mbeturina druri” i Shoqatës Kombëtare të Pronarëve të Pyjeve Private – NZ “Privatni Shumi” me seli në Berovë. Përveç mbështetjes financiare nga GEF-PMG (Fondi Global Ekologjik – Programi për Grante të Vogla) me gjysmën e financiare të nevojshme për realizimin

e aktiviteteve, partnerë të projektit janë edhe SNV Maqedoni dhe Komuna e Berovës. Buxheti i plotë i projektit është 61.087.00 USD ndërsa afati përfundimtar i aktiviteteve të projektit është 31.05.2013.

Ky projekt do të kontribuojë për realizimin e qëllimeve të GEF-PMG projektit në fushën qendrore: ndryshimet klimaterike. Kjo do të arrihet me ndryshimin e karburanteve fosile me burim të ripërtërishëm të energjisë ndërsa në kohen e njëjtë edhe prezantim të sistemit më efikas për ngrohje, që do të minimizojë lëshimin e gazrave në atmosferë. Me këtë projekt gjithashtu do të kontribuohet për zhvillimin e ekonomisë rurale duke përfshirë pronarë të pyjeve private (PPP) nga Berova në prodhimtarinë dhe shpërndarjen e bujashkave të drurit, që do të përdoret si karburant për ngrohjen e ujit të sistemit qendror për ngrohje të objekteve që janë në përgjegjësi të pushtetit lokal.

Qëllimi i këtij projekti është të ndryshojë sistemin momental të ngrohjes në shkollën e fshatit Dvorishtë – komuna e Berovës që si burim energjie përdor karburant fosili. Ndryshimi do të realizohet nëpërmjet instalimit të sistemit që punon në copë druri (bujashka) të cilat do të prodhohen nga anëtarët e NZPPP.

Me përfundimin e projektit drejtpërdrejtë do të zvogëlohen emisionet e CO₂ për 16,14 ton/vjet.

Projekti është i qëndrueshëm, pasi që siguron kursim prej disa mijëra dollar në nivel vjetor, që do të jetë nxitje edhe për subjektet tjera në komunën e njëjtë dhe komunat tjera që të përsëritet ky projekt.

Ky projekt do të siguron të ardhura për OJQ dhe popullatën rurale (pronarët e pyjeve private, pronarët e zdrukthëtarëve të vogla) nëpërmjet shitjes së mbeturinave nga druri ose pyjet që mbeten pas përpunimit fillestar të drurit. Gjithashtu siguron përfitim për komunitetin lokal në zvogëlimin e shpenzimeve për nxehje dhe uljen e emisioneve të CO₂ (mjedis të shëndetshëm jetësor).



„NËPËRMJET DRITARES SË TË NESËRMES MË TË MIRË“

Rrjeti për Zhvillim Rural në pajtim me programin vjetor, ka vazhduar me mbështetjen e anëtarëve. Në sajë të fushës prioritare – “Përforcimi ekonomik i grave në viset rurale”, dhe në bashkëpunim me “Etno Beba” nga Kumanova, ka organizuar një karvan të dedikuar ditës ndërkombëtare të gruas rurale. Karvani ishte organizuar në f. Pčinja dhe në f. Mllado Nagoričanë. Ishin të ftuar gratë nga viset rurale, gratë fermerë dhe sipërmarrës të rajonit të Kumanovës. Në kuadër të këtij aktiviteti ishin organizuar më tepër evenimente dhe ishte mbajtur një prezantim për rolin e gruas në amvisëritë rurale dhe mundësitë e gruas rurale për sipërmarrje, i dhe rëndësia e shfrytëzimit të resurseve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore si dhe një prej mënyrave për përmirësimin e cilësisë së jetesës në viset rurale.

Gjithashtu, në fshatin Pčinja ishin mbjellë 500 fidanë të pishave të bardha ndërsa përfaqësuesi i Muzeut Popullor në Kumanovë prezantoi traditën dhe kulturën e rrethinës. Ishte prezantuar edhe mundësia e këtyre viseve për prodhimtari bujqësore, posaçërisht prodhimin e luledielli me çfarë edhe njihet kjo pjesë e territorit.

Në fshatin Mllado Nagoričanë ishte zhvilluar një takim i grave nga viset rurale të rajonit planifikues verilindor, me titullin “Nëpërmjet dritares së të nesërme më të mirë”. Në ngjarjen kanë marrë pjesë më tepër se 100 gra nga viset rurale të gjithë Maqedonisë, anëtarët e shoqatës humanitare “Esma dhe Stevo Teodosievski”. Pjesëmarrësit erdhën në përfundim që ka nevojë për lobim dhe përfaqësim për të siguruar kushte më të volitshme të fillimit të biznesit për gratë në viset rurale. Nga pjesëmarrësit ishte përgatitur edhe ushqim tradicional të këtij rajoni, që mundeshe të degustohet në kompleksin “Etno Selo” në f. Mllado Nagoričanë.





„TË KUJDESEMI PËR KULTURËN DHE TRADITËN –Zhvillimi i turizmit në krushevë“

Misioni i “Cvet” është të ndihmojë gruan krushevase të emancipohet në gjitha sferat e jetesës shoqërore, të përforcohet ekonomikisht dhe të ndihmojë financiarisht familjen e vet. Prej themelimit të OJQ-së sonë, ne promovojmë kulturën dhe traditën e Krushevës në manifestime të ndryshme, incizime të emisioneve televizive nga stacionet e huaja, vizita të ambasadave, organizim të etno panairove, etj.

Qëllimi i projektit të cilin e zbaton “Cvet”, i financuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, është të zbatojë arsimin e të rinjve që do të jenë trashëgues të organizatës sonë, sepse anëtarësia jonë është në moshë më të vjetër. Me atë të rinjtë e edukuar do të vazhdojnë kulturën dhe traditën tonë shekullore që është specifike, interesante për turistët e huaj dhe vendor të cilët vizitojnë gjithnjë e më tepër qytetin. Të përmendim që për turistët janë interesante punimet me dorë, ushqimi i Krushevës, folklori dhe “Oda Krushevase – traditë shekullore” tradicionale.

Aktivitetet zbatohen në formë të edukimeve, përgatitjes së broshurës “Gatuesi i Krushevës”, themelimi i një grupi të vogël folklorik për rigjallërimin e valleve dhe këngëve. Për këtë grup qepen edhe fustane qytetare të vjetra, të cilat do të jenë identike me një model që i është dhuruar organizatës sonë dhe është i vjetër rreth 150 vite. Me këto fustane të rinjtë do të marrin pjesë në etno panairot “Mikpritja Krushevase” dhe promovimin e “Odës Krushevase”.

Jemi të bindur që me këto aktivitete do të tërhiqen një numër i turistëve. Arsimi-trajnimi kishte tre qëllime:

- Trajnim i 15 të rinjve për të mësuar dizajnë të thurjes

dhe qepjes sipas trendeve të reja bashkëkohore. Me atë do të përpunonin punime dore që nuk do të kanë çmime të larta. Punimet e tyre janë tërheqëse për turistët dhe me atë të rinjve ju ofrohet mundësi për hapjen e një biznesi të vogël;

- Trajnim i të rinjve për gatimin e specialiteteve krushevase të cilat janë specifike dhe janë të kërkuar nga turistët dhe që nuk i ofrojnë restorantet lokale;

- Trajnim i të rinjve për folklor dhe muzikë të vjetër qytetare;

- Përgatitje e broshurës me receta për ushqime tradicionale krushevase;

- Qepje të fustaneve të vjetra qytetare në cilat do të përfshihen gratë rrobaqepëse vullnetare.

Gjatë punëtorisë janë thurur 15 shalle-perelini, që është modeli i organizatës tonë dhe do të përdoret për nevojat e grupit folklorik.





DIMENSIONET E SHUMTA TË LEADER DHE BASHKËPUNIMI

Burim: Rrjeti Evropian për Zhvillim Rural

Gjatë 20 viteve të zbatimit të qasjes LEADER, Grupet Lokale Aksioni kanë kërkuar të mësojnë nga njëri-tjetri në mënyrë formale dhe informale. Me rritjen e punës së përbashkët, gjithashtu edhe projektet janë bërë më të ndërlikuar si dhe ndërlikimi i pakove financiare për t'i zbatuar.

Masa e bashkëpunimit në boshtin 4 të Politikave për Zhvillim Rural 2007–2013, të financuar nga Fondi Evropian Bujqësor për Zhvillim Rural (FEBZHR) në përputhje me nenin 65 të Rregullores së Këshillit 1698/2005, i lejon GLA-të të marrin veprime të përbashkëta me ndonjë LEADER grup tjetër ose me ndonjë grup që ka veprime të ngjashme me LEADER nga ndonjë rajon tjetër, shtet evropian ose shtete tjera. Veprimet e përbashkëta zhvillohen në bazë të marrëveshjes për partneritet dhe zbatimi zakonisht koordinohet nga partneri kryesor GLA. Të gjitha projektet për bashkëpunim duhet të shpijnë drejt rezultateve të qarta, që japin përfitime për gjitha territoret rurale të përfshira. Duke u bazuar në mësim të përbashkët, pritet që bashkëpunim të rezultojë në vlerë të vërtetë të shtuar për rajonet pjesëmarrëse. Qasja në informata të reja dhe ideja ju mundëson partnerëve në bashkëpunim që bashkërisht të trajtojnë një çështje specifike lokale zhvillimore. Pothuaj se 5% (€265 milion) të fondeve totale të FEBZHR është buxhetuar për zbatimin e projekteve bashkëpunimi ndërterritoriale dhe ndërkufitare. Si një vegël për zbatimin e Strategjive Lokale Zhvillimore (SLZH), aktiviteti bashkëpunues i ofron GLA-ve vetëbesimin për të shpikur. Duke punuar bashkërisht, ndarë rreziqet dhe përdorimin i përvojave të njëri-tjetrit zmadhon shakat për sukses. Me projektet e shumta bashkëpunimi që zhvillohen dhe zbatohen nga vetë GLA-të (dhe jo nga aktorë tjerë që aplikojnë për financimi) ata ofrojnë mundësinë për të zbatuar deri në

fund strategjinë në mënyrë që aktorët individual nuk do të arrijnë.

Ndonëse ka rritje të përvojës me bashkëpunim, projektet e tilla ende mbeten një sfidë për të zhvilluar. Mbështetja që jepet ka bërë më të lehtë procesin e identifikimit të partnerëve përkatës; megjithatë, përpunimi i detajeve të projektit, përgjegjësitë dhe financimi mund të sërish të jetë sfiduese kur punoni në gjuhë të ndryshme dhe me kulturë dhe kufizime administrative. Përkaj këtyre, ka shumë projekte që ofrojnë dëshmi si përpjekjet për bashkëpunim nga bashkësitë rurale në periudhën momentale të projektit mund të rezultojnë me diçka konkrete.

BASHKËPUNIMI PËR TË PËRMIRËSUAR CILËSINË E JETËS

Projekti "Cilësia e Jetës Nëpërmjet Afrimit" ("Lebensqualität durch Nähe – LQN") punon për të siguruar që shërbimet themelore dhe furnizime lokale janë të gatshme në viset rurale, duke trajtuar sfidat kryesore të ndryshimeve rurale demografike dhe klimën momentale ekonomike. Shumë shitore, banka dhe posta janë duke u tërhequr nga viset rurale, të ngarkuar tepër nga shtypjet ekonomike dhe kostot e larta të mirëmbajtjes si dhe fuqia e dobët e blerjes. AGL-të pjesëmarrëse nga Gjermania dhe Austria janë me shpresë se do të gjejnë zgjidhje për të mirëmbajtur dhe përmirësuar madje cilësinë e jetës në viset rurale. Projekti i bashkëpunimit LQN ka për qëllim të mbështet bashkësitë lokale për zhvillimin e aktiviteteve inovative dhe të integruar që do të ofrojnë shërbime gjithëpërfshirëse dhe do të furnizojnë ushqim lokal.



Projekti do të jetë i qëndrueshëm sepse drejt synon nevojat e bashkësive, nxit pjesëmarrjen e popullit lokal të përkushtuar dhe merr mbështetje nga bashkëpunimi ndërkuftar. Shkëmbimi i ideve të reja, impulsi i ri që vije duke punuar me partnerë të rinj dhe miratimi i shembujve të praktikave inovative janë një siguri për zhvillimin e qasjeve të reja për ofrimin e shërbimeve. "Rajonet partnere kanë zbuluar se problemet i kanë të njëjta dhe prandaj kanë dashur të bashkëpunojnë për të mbështetur njëri-tjetrin me zhvillimin dhe zbatimin e zgjidhjeve, thotë Ingrid Engelhart, koordinatori i projektit të partnerit kryesor gjerman LAG Nordschwarzwald. Vizitat e partnerëve janë fokusuar në projekte të freskëta që kanë për qëllim kujdesin e cilësisë së jetës në viset rurale. Kurset ndërkufitare për trajnim që janë mbajtur në rajonet e Austrisë dhe Gjermanisë, janë përbërë nga gjashtë module dhe një simpozium final. Pastaj, pjesëmarrësit kanë zhvilluar zgjidhje të përshtatur për nevojat e tyre specifike lokale. Për shembull, pleqtë do të kenë një person të caktuar kontakti nëse kanë nevojë për ndihmë, forma inovative të strehimit dhe kujdes që përfshin takime të rregullta, dalje çlodhëse dhe kujdes ditor për persona me çmendur janë themeluar dhe qendra që ofrojnë ushqim lokal dhe mallra tjera themelore, të bashkuar me shërbimet publike-private, kujdes social dhe mjekësor, shërbimet komunikimit dhe kulturore. Strategjitë zhvillimore të AGL-ve partnere kanë për fokus sigurimin e jetës cilësore duke mirëmbajtur furnizimin e shërbimeve themelore dhe nevojave. "Me anë të bashkëpunimit ne kemi identifikuar një koncept inovativ dhe shpresojmë që të jetë zgjidhje afatgjate për atë si të menaxhojmë ekonomikisht një shitore në njërin prej fshatrave tonë, edhe pse ka fuqi të dobët blerjeje nga popullata", sqaron Andreas Schilcher, menaxheri i LEADER Region Nationalpark Kalkalpen, një prej GLA-ve partnere austriake. Për shkak të këtyre shembujve pozitiv AGL-të pjesëmarrëse dëshirojnë të bashkëpunojnë në projekte tjera. Në mesin e tyre është plani i fillimit dhe zbatimit të formave inovative "pa barrierë" të jetesës për personat e moshuar, përfshirë edhe opsionin e kujdesit dhe me këtë nxitet rigjallërimi dhe ripërtirja rurale.



An alle Direktvermarkter ...denn das Gute liegt so nah!

Sind Sie Landwirt oder anderweitiger Direktvermarkter Ihrer eigenen Produkte von Kartoffeln, Eiern, Honig und vielem mehr? Dann möchten wir, der AK1 (Nahversorger) Ihnen in Kürze eine Plattform in Form einer Produktliste von aktuellen Angeboten unserer Direktvermarkter im Amtsblatt bieten.

Die Erfahrung zeigt, dass es zahlreiche Direktvermarkter in Neubulach und den Teilorten gibt, die qualitativ hochwertige Produkte hier herstellen und vermarkten, aber dies in Neubulach gar nicht oder nur wenig bekannt ist.

Doch artgerechte Tierhaltung, ökologische Landwirtschaft, kurze Transportwege, faire Preise und die gute Qualität aus der Region sprechen für sich.

Um Ihre Produkte für Neubulach noch nutzbarer zu machen und die "Qualität aus der Nähe" den Bürgern näher zu bringen, möchte der AK1 ca. alle zwei Wochen eine Liste mit den von Ihnen gemeldeten Produkten im Amtsblatt veröffentlichen.

Dieser Service ist für Sie kostenfrei!

Haben Sie Interesse daran, Ihre aktuellen Produkte mit aufnehmen zu lassen oder haben Sie noch Fragen dazu, dann kontaktieren Sie Margit und Martin Schötle, per Tel. (07053) 6570 oder per E-Mail an info@martinschoettle.de



BASHKËPUNIMI PËR NDRYSHIMET KLIMATERIKE

Malet Cheviot janë vargmale në veri të Anglisë, që shtrihen në kufirit anglez-skocez. Projekti ishte zhvilluar nga një kooperativë e përfaqësueseve nga agjencitë dhe organizata që janë të përfshirë në punë me bashkësitë rurale në këtë rrethinë. "Iniciativat e Ardhshme Cheviot" filluan me një projekt që fokusoheshin në pjesën rreth lumit Tweed dhe që ndihmoi fermerëve dhe pronarëve të tokave të marrin hapat e nevojshme për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimaterike me një sërë projektesh demonstrimi që kanë parashikuar zhvillimin e teknikave bujqësore dhe shkëmbimit të praktikave më të mira. Një pjesë e projekteve më të shkurta kanë trajtuar ndryshimet e shumta të ndryshimeve klimaterike me të cilat përballohen bashkësitë rurale, si vërshime të mëdha dhe lëvizje më e shpejtë e tokës dhe ndotësit, thatësi, zjarre, erozione ere dhe efektet mbi bagëtinë dhe peshqit. Suksesi i këtij projekti të parë ka inkurajuar



agjencitë të zgjerohet edhe më tepër dhe të formohet një projekt ndër-territorial dhe do të përfshinte edhe malet e Northumberland dhe ato afër kufirit të Skocisë dhe për secilin ishte themeluar AGL. Menaxheri i AGL-së nga Northumberland, Tom Burston deklaroi: "Përfitimet që të merret një qasje bashkëpunimi për këtë çështje janë të mëdha sepse praktikatat e menaxhimit të tokave dhe kushtet e ndryshueshme klimaterike nuk përputhen me kufijtë e LEADER. Për shembull, disa aktivitete që janë ndërmarrë me këtë projekt është janë përqendruar në pjesën e lumit dhe përreth kufijve të LAGL-së. Gjithashtu, kushte të ngjashme të tokës janë gjetur në dy anët e kufirit andaj mësimet dhe praktikatat më të mira mund të shkëmbehen mes Northumberland dhe territoret e Skocisë".

Faza e dytë e projektit është ngritja e vetëdijes mbi kërcënimet e parashikuara dhe mundësitë e ndryshimeve klimaterike në këtë pjesë dhe ka për qëllim të zbatojë qasje të thjeshta praktike për menaxhimin e tokës që ka për fokus adaptimin ndaj efekteve të ndryshimeve klimaterike. Kjo arrihet me shkëmbimin e praktikës më të mirë për të mbështetur dhe ndryshuar bizneset

rurale, varësisht prej mundësisë. Çelësi është angazhimi i vazhdueshëm me fermerët dhe menaxherët e tokave për të zhvilluar dhe miratuar zgjedhje të reja të qëndrueshme për të trajtuar ndikimet nga ndryshimet klimaterike. Këto zgjedhje ofrohen bashkësisë më të gjerë dhe japin durim ekonomik dhe gjithashtu mbështetin bizneset lokale duke ju ndihmuar të jenë më të durueshëm ndaj ndryshimeve klimaterike. Projekti ofron një këshilltar që punon drejt me fermerët dhe menaxherët e tokave për të mundur të inkorporojnë masat për ndryshimet klimaterike në praktikatat e tyre afariste, përfshirë edhe zbulimin e planeve të pilotuara me sukses për vërshimet në ferma. Zyrtari i projektit gjithashtu do të krijojë edhe një katalog të gjatë të projekteve dhe praktikave të mira për të pasur ndikim më afatgjatë mbi fermerët dhe menaxherët e tokave në pjesën e lumit dhe të ulët rreziku nga vërshimi dhe përmirësimi i durimit të tyre ndaj ndryshimeve klimaterike. Qasja pasqyrohet mbi nevojat e menaxherëve të tokës dhe siguron që fokusi të jetë mbi zgjedhjet praktike të problemeve të vërteta dhe me shpresë që kjo do të nxit menaxherët e tokave tjera të investojnë në masat e adaptimit.



DEKLARATA E BRUKSELIT: Ruajtja e ardhmërisë së qasjes LEADER

Më 27 dhe 28 prill, 2012, më tepër se 400 ekspertë lokal zhvillimor nga 300 Grupe Lokale Aksioni dhe përfaqësuesit e gjitha 27 shteteve anëtare janë takuar në Bruksel për ENRD Leader konferencën "Strategjitë Lokale Zhvillimore dhe bashkëpunimi: qasjet kryesore për zhvillim lokal" për të nisur përgatitjet e tyre për zhvillimin lokal 2014-20 të udhëhequr nga bashkësia që është planifikuar për të kontribuar drejt arritjes së qëllimeve të EURO2020.

Në bazë të rregulloreve mbështetëse për periudhën vijuese programimi 2014-2020 dhe paraqitja e zhvillimit lokal të udhëhequr nga bashkësia si vegël kryesore, pjesëmarrësit e konferencës kanë nënshkruar deklaratën më poshtë për mbështetje të qasjes LEADER:

- Iniciativa e komisionit për të sjellë zhvillimin lokal të bashkësisë dhe qasjen me mbështetje financiare në maje për periudhën vijuese të programimi është për të uruar. Kjo gjithashtu tregon njohjen nga komisioni potencialin e vërtetë dhe ndikimin pozitiv metodat prej lart poshtë, thelbësore dhe qasjet e ndryshme mund të kenë mbi regjenerimin e ekonomive në stagnacion dhe rigjallërimin e rajoneve rurale në tërësi.
- Duke marrë parasysh këtë, procesi i sigurimit të financimit përkatës nga bashkësia për territoret e BE-së nuk duhet të rezultojë me uljen e financimit të Leader në sajë të shtyllës së dytë të Politikave të Përbashkëta Bujqësore sepse për pjesën më të madhe të 2.300 GLA-ve të BE-se, zhvillimi rural ende do të mbetet fusha kryesore e veprimit në periudhën 2014-20.



- Qasja Leader është vegla ideale për mbështetjen e strategjisë Evropë 2020 në kuptim të rritjes “me mençuri”, “qëndrueshme” dhe inkluzive. Mijëra GLA kanë demonstruar se me zbatimin e pikave specifike të qasjes Leader mund të arrihen zgjidhje inovative, dhe të qëndrueshme në planin mjedisor dhe shoqëror, për zhvillimin rural si dhe për të mbështetur mobilizimin e potencialit unik njerëzor, social, ekonomik dhe kulturor të Evropës rurale.
- Andaj, ulja e buxhetit të caktuar për Leader me siguri do të rezultojë me uljen e numrit të fillimeve të bizneseve të reja, rritjen e papunësisë, shërbime të përgjysmuara dhe do të rrezikojë gjeneratën e plotë të mirëqenies në rajonet rurale.
- Duke pasur në zemër mirëqenien dhe qëndrueshmërinë e rajoneve rurale dhe bashkësive, ju apelojmë krijuesve të politikave të vazhdojnë me përkushtimin e tyre për të ndarë 5% për Leader nga fondet për zhvillim rural.
- Pas publikimit të fakteve nga raporti i Gjykatës Evropiane të Revizorëve mbi zbatimin e Leader (raporti special Nr 5/2010), ENRD-ja themeloi një Grup Fokusi që përfshin aktorë të ndryshëm kryesisht nga shtetet anëtare që kanë për fokus përmirësimin e cilësisë dhe ndikimit të Strategjive Lokale Zhvillimore. Theks i posaçëm është vendosur mbi përmirësimin e metodave të matjes dhe dokumentimit për të shfaqur vlerën e shtuar të qasjes Leader. Paralelisht me Grupin e Fokusit, me një orvatje për të mbështetur programimin e udhëhequr nga bashkësia dhe implementimin në nivelin kombëtar dhe nivelin e GLA-ve, ishin mbledhur shumë informata të vlefshme, praktika relevante dhe rekomandime mbi dizajnimin e zbatimit të SLZH. Nëse financimi për Leader ulët, atëherë rezultatet e Grupit të Fokusit me siguri nuk do të përdoren maksimalisht ndërsa kapacitetet për të zbatuar rekomandimet në praktikë do të frenohen dukshëm, dhe me këtë duke penguar përmirësimet e mëtutjeshme të qasjes Leader.

Ne, pjesëmarrësit në ENRD konferencën “Strategjitë Lokale Zhvillimore dhe bashkëpunimi: qasjet kryesore për zhvillim lokal” të mbledhur në Bruksel, apelojmë krijuesit e politikave:

- Të kujdesen për zbatimin e lehtë dhe papengesa të qasjes Leader duke siguruar së paku 5% nga fondi për Zhvillim Rural.

Dhe nga kjo

- Të bëhen viset rurale më tërheqëse për personat që jetojnë dhe punojnë dhe të bëhen qendra të jetës më cilësore për një llojllojshmëri të popullatës nga gjitha grupmoshat;



bioregions.eu

PROJEKTI - BIORAJONE



Pasqyrë e projektit

Projekti i biorajoneve mbështet krijimin e “rajoneve bioenergjetike” në viset rurale të Evropës. Rajonet e tilla kanë për qëllim që së paku 1/3 të nevojave të tyre për ngrohje dhe elektricitet të jetë nga burimet lokale dhe bioenergjetike, me fokus në biomasën e fortë.

Duke u bazuar në praktikat më të mira që janë zhvilluar në rajonet më përparimtare bioenergjetike në Evropë, projekti momentalisht mbështet krijimin e pesë rajoneve të reja bioenergjetike në Sredna Gora (Bullgari), Slavcin dhe Brumov-Bylnice (Republika Çeke), Trieves (Francë), Westmeath Komunën (Irlandë) dhe Limbazi (Letoni).

Projekti gjithashtu ka për qëllim të inspirojë rajone tjera rurale të Evropës të ndjekin shembullin tonë të rajoneve synuese.

Projekti i biorajoneve ka filluar në maj 2010 ndërsa konzorciumi është i përbërë nga 13 partnerë në 10 shtete evropiane.

Disa fakte themelore mbi bioenergjinë

- Bioenergjia është një formë e energjisë së ripërtërishme nga më tepër burime (erë, diell, ujë, etj.)
- Bioenergjia, nëse prodhohet në mënyrë të qëndrueshme, kursen nga emisionet e gazrave.
- Bioenergjia përfshin më tepër se dy të tretat e energjisë së plotë të ripërtërishme në BE.
- Biomasa për energji kryesisht merret nga pylltaria, bujqësia dhe mbeturinat organike.
- Rezervat e bioenergjisë mund të magazinohen; andaj bioenergjia mund të prodhohet vazhdimisht është burim i siguritë i energjisë.
- Biomasa është e gatshme në shumë pjesë të Evropës.
- Biomasa mund të jetë e fortë, lëngshme ose gaz dhe mund të përdoret për prodhimin e rrymës, ngrohjes ose karburant.



Pse bioenergji...? bioenergja dhe zhvillimi rural

Biomasa është burimi më i përdorur i energjisë së ripërtërishme në Evropë dhe 80% vije nga druri.

Andaj, prodhimi i bioenergjisë është një funksion i rëndësishëm i pyjeve Evropian dhe **sektori ekonomik në rritje** me potencial për nxitjen e **zhvillimit ekonomik** dhe **punësimit në viset rurale**. Bioenergja nga druri nuk është vetëm e ripërtërishme por konsiderohet të jetë edhe pa karbon, andaj prodhimi i energjisë nga druri është i mbështetur me strategjitë e BE-së për vitin 2020 që të përdoret 20% i burimeve të ripërtërishme për prodhimin e energjisë si dhe 20% të uljes së emisioneve të karbonit.

Bioenergja **sjell investime të reja** në sektorin bujqësor që gjatë dekadave të fundit ka përjetuar përmirësime të prodhimtarisë përpara uljes së çmimeve të vërteta për ushqim dhe artikuj bujqësor. Investimet e reja mund të ofrojnë **treg dhe mundësi për punësim**. Rritja e bioenergjisë, nëse menaxhohet në mënyrë të drejtë, mund të kontribuojë për **përmirësimin e infrastrukturës dhe qasjes në treg në viset rurale**. Bioenergja moderne mund të jetë edhe burim i pastër i energjisë në viset rurale që ofron mundësi të reja për modernizimin e bujqësisë dhe ekonomisë rurale dhe të përmirësojë qasjen në servise moderne të energjisë për amvisëri. Ulja e ndotjes brenda shtëpive duke kaluar në biokarburantë më të pastër **mund të përmirësojë edhe jetesën**.

Ka shumë arsye tjera pse të përdorni biomasë:

- Biomasa është energjia diellore e ruajtur në materien organike
- Biomasa është burim i ripërtërishëm i energjisë
- Biomasa për ngrohje, rryme dhe karburante pritet të ndihmojë shumë në furnizimin e ardhshëm të energjisë në Evropë
- Biomasa e përshtatshme për nevoja themelore
- Përdorimi i biomasës në vend të karburanteve fosile do të zvogëlojë varshmërinë nga nafta
- Përdorimi i biomasës në vend të karburanteve fosile do të zvogëlojë emisionin e gazrave
- Biomasa dhe bioenergja do të sigurojnë të ardhura plotësuese për fermerët dhe do të kontribuojë për zhvillimin e rajoneve rurale

A jeni të interesuar?

Me gjithë nder do t'ju ndihmojmë të filloni biorajonin në territorin e juaj!

Për më tepër informata, vizitoni ueb faqen: www.bioregions.eu

Na kontaktoni për të mësuar më tepër për bioenergjinë dhe përfitimet për rajonet rurale: info@bioregions.eu ose elard@elard.eu

Përgjegjësia e vetme për përmbajtjen e këtij dokumenti mbetet në autorët. Ajo nuk pasqyron detyrimisht mendimin e Bashkimit Evropian. As EACI as Komisioni Evropian nuk janë përgjegjës për përdorimin e informatave që janë përmbajtur në këtë fletë.